Numër: 01-374
Datë: 22.05.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, nenin 108 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr.05/L-031, datë 25 Maj 2016), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 02.05.2025 nxjerr këtë:

VENDIM

I. Shtyhet afati fillestar për shqyrtimin e ankesës së Institucioni ATC me nr. 01/233 të pranuar me datë 21.03.2024, kundër vendimeve të KD Nr.Ref: 01/458 datë 08.07.2024 dhe vendimit të KD Nr.Ref:01/402 datë 21.06.2024 për akreditim me kushte.

II. Vendimi që zgjidh ankesën do të merret brenda afatit ligjor të përcaktuar me LPPA, por jo më larg se afati fillestar prej 30 ditësh.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Institucioni ATC me datë 21.03.2024 në AKK ka parashtruar ankesën me nr. 01/233 kundër vendimeve të kundër vendimit të KD Nr.Ref: 01/458 datë 08.07.2024 dhe vendimit të KD Nr.Ref: 01/402 datë 21.06.2024 për akreditim me kushte.

KD pas pranimit të ankesës bazuar në nenin 131 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa u shprehur mbi të, të njëjtën e ka përcjellë në Këshillin Drejtues të AKK bazuar në paragrafin 5 të nenit 131 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

KD i AKK-së pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe pretendimeve të palës ankuese, ka konstatuar se nevojitet afat kohor shtesë për shqyrtim administrativ, për shkak të kompleksitetit të çështjes konkrete administrative respektivisht vlerësimit profesional lidhur me relevancën e ankesës për procesin e akreditimit me kushte.

Pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe kompetencat, KD vendosi si në dispozitiv.

Vendimi u dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Arkivit të AKK.*

Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK